



Pranuar / Datozuar Priljena / Pristalo Received / Delivered	14.03.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	No Prot Br Prot Prot No	Shtojç / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SILINSKI	2657/2023		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A.nr.297/2023**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.297/2023 të datës 01.02.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, nga Gjilani, kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, ne çështjen juridike "transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.03.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.297/2023 e dates 01.02.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ r në Shërbimin Korrektues të Kosovës sipas Akt emërimit me numër AE.Nr.065/2022 të datës 12.07.2022, me datën 01.02.2023 përmes Postës së Kosovës ka parashtruar ankesën me numër protokolli 1187/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshill është pranuar po me këtë datë nën shenjen A.nr.297/2023, kundër Vendimit Nr.120 të datës 26.01.2023 të lëshuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektimit të Kosovës lidhur me transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita e Zëvendës Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren në pozitën e Zëvendës Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 08.02.2023 ka

proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datën 21.02.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 1187/2023 të datës 01.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankuesit me numër AE.Nr.065/2022 të datës 12.07.2022; Vendimin Nr.120 të datës 26.01.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Certifikatën e vendbanimit të ankuesit me numër Nr.B 10434031 të datës 30.01.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 21.02.2023 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Kërkesën e datës 26.01.2023 përmes e-mailit zyrtar; Formularin mbi përkrimin e detyrave të punës së ankuesit të datës 05.01.2012; E-mailin zyrtar të datës 13.03.2023 si dhe Vendimin 08 Nr.298 të datës 13.03.2023 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit Fidan Hasani, është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me këtë ankesë ka konstatuar se me datën 13.03.2023 Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës përmes e-mailit zyrtar, ka përcjell në Këshill shkresën sqaruese lidhur me Vendimin numër 08Nr.298 të datës 13.03.2023, të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, sipas së cilës është shfuqizuar Vendimi Nr.120 i datës 26.01.2023 me të cilën ankuesi është transferuar përkohësisht nga pozita e Zëvendës Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren në pozitën e Zëvendës Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan për afatin prej gjashtë (6) muajsh, e cili vendim ka qenë objekt shqyrtimi me rastin e parashtrimit të ankesës së ankuesit në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të kësaj rrethane konstaton se objekti i shqyrtimit të ankesës së ankuesit të datës 01.02.2023 në Këshill, është bërë i pamundur ose i kotë, bazuar në konstatimin e mësipërm e krejt kjo në pajtim me nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*, andaj edhe ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ lidhur me ankesën e ankuesit Fidan Hasani, në pajtim edhe me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.297/2023, datë 14/03/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



**Vendimi i dërrkohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së